Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0639

Paneli Shqyrtues, duke vendosur në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani dhe Batisha Ibrahimi - Anëtar,, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) lidhur me ankesën e OE "Ved Group" SH.P.K., ushtruar kundër Njoftimi për kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi dhe funksionalizimi i shtepise per mbrojtjen e femijeve" me numër të prokurimit:632-26-5571-5-1-1, iniciuar nga Komuna e Gjakoves në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), më 19/10/2026, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE"Ved Group" SH.P.K., me nr. 2026/0639 e datës 24/08/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi dhe funksionalizimi i shtepise per mbrojtjen e femijeve"me numër të prokurimit:632-26-5571-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktuesKomuna e Gjakoves (AK), ndërsa AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

3. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjeserisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komuna e Gjakoves në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndertimi dhe funksionalizimi i shtepise per mbrojtjen e femijeve" me numër të prokurimit: 632-26-5571-5-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë, vlera e parashikuar e kontratës: 650,000.00 €.

Me 12.08.2026, OE"Ved Group" SH.P.K.ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim. Kerkesa i eshte refuzuar si e pa bazuar nga Autoriteti Kontraktues.

Me 24.08.2026, OSHP ka pranuar ankesën nga OE"Ved Group" SH.P.K.,me nr. 2026/0639 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi dhe funksionalizimi i shtepise per mbrojtjen e femijeve" me numër të prokurimit: 632-26-5571-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Ved Group" SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Ne si operator ekonomik në këtë procedurë të prokurimit, paraqesim këtë ankesë, në përputhje me nenin 108 të Ligjit për Prokurim Publik.

Sipas nenit 5 të LPP, afatet kohe duhet te fillojne ne dite pune dhe te perfundojne ne dite pune andaj dita e 10 pas refuzimit te kerkeses per rishqyrtim ka qene me date 23.08.2026 e diele andaj afati zgjatet me date 24.08.2026.

PRETENDIMI 1.

Pretendimi 1.

Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit ka përcaktuar kërkesën:

"Kamionë me konstruksion kiper me peshë totale maksimum 1t (kamioni duhet të ketë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit).

” Konsiderojmë se kërkesa e përcaktuar në këtë mënyrë është e paqartë, joprecize dhe në kundërshtim me vetë natyrën e mjetit të kërkuar.

Pas verifikimeve të bëra dhe informatave të kërkuara pranë institucioneve përkatëse, respektivisht qendrave për regjistrimin e automjeteve, rezulton se formulimi “kamion me peshë totale maksimum 1t” nuk është në përputhje me kategorizimin përkatës të mjeteve. Vetë nocioni “kamion”, sipas legjislacionit përkatës të transportit, ndërlidhet me mjete me masë/peshë mbi 3.5 ton, ndërsa Autoriteti Kontraktues në të njëjtën kërkesë ka kërkuar “kamion me konstruksion kiper” dhe njëkohësisht ka kufizuar peshën totale të tij në maksimum 1 ton.

Rrjedhimisht, kërkesa e vendosur nga Autoriteti Kontraktues përmban një kundërthënie të drejtpërdrejtë: nga njëra anë kërkohet kamion me konstruksion kiper, ndërsa nga ana tjetër kërkohet që pesha totale e këtij kamioni të jetë maksimum 1 ton.

Konsiderojmë se ka mundësi që Autoriteti Kontraktues me kërkesën prej 1 ton të ketë synuar kapacitetin bartës/ngarkues të automjetit kamionit ose kamionetes dhe jo peshën totale të tij.

Në këtë drejtim, Neni 25.17 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik – versioni i konsoliduar, përcakton se të gjitha kërkesat minimale për kualifikim duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.

Gjithashtu, Neni 19.4 i Rregullores përcakton se përshkrimi i specifikimeve teknike/termave të referencës duhet të jetë i qartë, i saktë dhe preciz, nuk duhet të paraqesë kufizime të paarsyeshme në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca dhe nuk duhet të krijojë paqartësi rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara.

Kemi kerkuar nga Autoriteti Kontraktues që këtë kërkesë ta rishqyrtojë dhe korrigjojë, duke përcaktuar qartë dhe saktë karakteristikat e mjetit të kërkuar dhe, nëse qëllimi i Autoritetit Kontraktues ka qenë përcaktimi i kapacitetit bartës/ngarkues prej 1 ton, atëherë kjo të përcaktohet shprehimisht si e tillë dhe të largohet formulimi “peshë totale maksimum 1t”.

Pergjigja e AK ka qene joproporcionale dhe jo adekuate sa i perket kesaj kerkese ku AK ne pergjigje ka thene se “gjithashtu, kërkesa nuk është diskriminuese dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi në treg ekzistojnë mjete të ndryshme me konstruksion kiper dhe kapacitet bartës afërsisht 1 ton, të cilat mund të përdoren për realizimin e kontratës” Edhe pse ne pergjigje ka thene qe kamioni duhet te kete peshe bartese 1 ton , ne dosjen e tendrit vazhdon te figuroje peshe totale 1 ton, kjo eshte e pakutimte duke e pasur parasysh qe nje automjet i thjesht peshon me shume se 1 ton e lere nje makineri pune kamion te kete peshetotale 1 ton max,

Kerkojme nga panely shqyrtues qe kerkesen kamion kiper me peshe totale max 1 ton te zevendesohet me peshe totale min 1 ton.

PRETENDIMI 2

Kërkesa e Dosjes së Tenderit ka qenë si më poshtë:

“Gjysëmrimorkio kiper kran me sinjalizues të punimeve me peshë totale maksimum 3.5t.”

Kërkesa e lartcekur është konfuze, e paqartë dhe tejet kufizuese, si në aspektin e emërtimit të mjetit ashtu edhe në karakteristikat e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Fillimisht, AK ka kërkuar gjysëmrimorkio, ndërsa askund në këtë kërkesë dhe në listën e mjeteve të Dosjes së Tenderit nuk ka kërkuar kokë tërheqëse për tërheqjen e saj. Logjikisht shtrohet pyetja se si është paraparë të përdoret gjysëmrimorkioja për realizimin e punimeve pa mjetin përkatës tërheqës. Nëse qëllimi i AK-së ka qenë të kërkojë rimorkio, atëherë duhet të korrigjohet emërtimi nga “gjysëmrimorkio” në “rimorkio”, pasi kemi të bëjmë me mjete të ndryshme dhe Operatorët Ekonomik nuk mund të supozojnë se çfarë mjeti ka pasur për qëllim AK.

Përveç kësaj, AK ka bashkuar disa karakteristika specifike në një mjet të vetëm, duke kërkuar gjysëmrimorkio me konstruksion kiper, me kran dhe me sinjalizues të punimeve, si dhe duke ia kufizuar peshën totale në maksimum 3.5 ton. Kombinimi i të gjitha këtyre karakteristikave në një mjet të vetëm e bën kërkesën tejet specifike dhe kufizuese, ndërsa nuk është sqaruar arsyeja apo domosdoshmëria që punët përkatëse të kryhen vetëm me një mjet me këtë konfigurim.

Qëllimi i kërkesës duhet të jetë sigurimi i kapacitetit teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës dhe jo kufizimi i Operatorëve Ekonomik në një konfigurim të rrallë dhe specifik të një mjeti, nëse të njëjtin funksion dhe të njëjtat punë mund ti kryejë një mjet tjetër ekuivalent.

Për këtë arsye, konsiderojmë se të njëjtën detyrë mund ta realizojë edhe një kamion me konstruksion kiper dhe kran, ndërsa duke iu referuar kufizimit të vendosur nga vetë AK prej maksimum 3.5 ton, mund të pranohet edhe kamionetë me konstruksion kiper dhe kran, me kusht që mjeti të posedojë karakteristikat dhe kapacitetin e nevojshëm për realizimin e punimeve.

Kërkesa në formën aktuale kufizon pa nevojë mundësinë e konkurrimit të Operatorëve Ekonomik të cilët posedojnë mjete që e kryejnë funksionin e njëjtë, por nuk e kanë pikërisht emërtimin dhe konfigurimin e përcaktuar nga AK.

Andaj kemi kerkuar nga Autoriteti Kontraktues që ta rishikojë dhe korrigjojë këtë kërkesë, duke sqaruar fillimisht nëse kërkohet gjysëmrimorkio apo rimorkio dhe, në rast se mbetet kërkesa për gjysëmrimorkio, të përcaktojë edhe mënyrën/mjetin e paraparë për tërheqjen e saj. Gjithashtu kërkojmë që të lejohet ofrimi i një mjeti ekuivalent që përmbush të njëjtin funksion dhe nevojat e projektit, përkatësisht kamion me konstruksion kiper dhe kran apo kamionetë me konstruksion kiper dhe kran, duke respektuar kërkesat funksionale të nevojshme për realizimin e kontratës.

Edhe per kete kerkese autoriteti kontraktues e ka refuzuar me arysetimin se :

Sa i përket pajisjes Gjysmë-rimorkio kiper me sinjalizues të punimeve me peshë totale maksimum 3.5 t, refuzohet siii i pabazuar. Autoriteti Kontraktues vlerëson se kërkesa e përcaktuar në Dosjen e Tenderit për "Gjysmërimorkio kiper me sinjalizues të punimeve me peshë totale maksimum 3.5 t" është përcaktuar në përputhje me nevojat reale dhe objektin e

kontratës, si dhe me kërkesat teknike dhe funksionale të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues. Pretendimi se specifikimi është konfuz apo kufizues vetëm për faktin se është kërkuar një gjysmë-rimorkio kiper me kran nuk qëndron. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të përcaktojë karakteristikat teknike të mjetit që i nevojitet për realizimin e qëllimit të kontratës, për sa kohë që këto kërkesa lidhen drejtpërdrejt me nevojat dhe objektin e prokurimit. Sa i përket pretendimit për mungesën e kokës tërheqëse, Autoriteti Kontraktues sqaron se kjo nuk e bën kërkesën të paqartë. Nëse në kuadër të kontratës kërkohet një gjysmë-rimorkio, mënyra e sigurimit dhe përdorimit të saj mund të realizohet në përputhje me konfigurimin dhe kapacitetin teknik të kërkuar. Për më tepër, operatorët ekonomikë kanë mundësi të ofrojnë zgjidhjen teknike që përmbush kërkesat e përcaktuara në Dosjen e 6/6 Tenderit. Gjithashtu, kërkesa për peshë totale maksimale 3.5 ton, si dhe për pajisjen me konstruksion kiper, kran dhe sinjalizues të punimeve, është përcaktuar për të garantuar që mjeti i ofertuar të jetë i përshtatshëm për përdorimin dhe punët për të cilat Autoriteti Kontraktues ka nevojë. Këto kërkesa nuk janë vendosur për të favorizuar një operator ekonomik të caktuar, por për të siguruar kapacitetin dhe funksionalitetin e nevojshëm të mjetit. Në këtë kuptim, fakti që një operator ekonomik mund të ketë në dispozicion një mjet tjetër, si kamion me konstruksion kiper dhe kran, nuk nënkupton domosdoshmërisht se ai mjet është teknikisht dhe funksionalisht i njëjtë me mjetin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Lidhur me pretendimet e OE"Ved Group" SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0639 ka vlerësuar si në vijim:

Pergjigje ne pretendimin ankimor 1

Pretendimi është i bazuar në pjesën që konteston qartësinë dhe saktësinë e formulimit "peshë totale maksimum 1 ton", për shkak të mospërputhjes ndërmjet kërkesës së publikuar në Dosjen e Tenderit dhe përgjigjjes në Kërkesën Për Rishqyrtim të dhënë nga Autoriteti Kontraktues.

Në këto rrethana, eksperti shqyrtues vlerëson se Autoriteti Kontraktues nuk ka arritur të argumentojë në mënyrë të mjaftueshme se pse "peshë totale maksimum 1 ton" është karakteristika teknike objektivisht e nevojshme për realizimin e kontratës, ndërsa vetë sqarimi i AK-së në Kërkesën Për Rishqyrtim tregon se qëllimi faktik ka qenë sigurimi i një mjeti me kapacitet bartës rreth 1 ton.

Për rrjedhojë, kërkesa në këtë formë nuk mund të konsiderohet mjaftueshëm e qartë dhe precize.

Megjithatë, kjo nuk nënkupton se AK është e ndaluar të kërkojë një mjet me kapacitet bartës 1 ton. AK mund ta përcaktojë këtë nevojë, nëse e arsyeton objektivisht dhe në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe konkurrencës, por duhet ta formulojë kërkesën në mënyrë të qartë dhe teknikisht të saktë.

Autoriteti Kontraktues mund të përcaktojë kërkesa teknike që burojnë nga nevojat reale të kontratës;megjithatë, formulimi "peshë totale maksimum 1 ton" nuk është i qartë në raport me përgjigjjen e dhënë në kërkesën për rishqyrtim nga AK.

Peshë totale" dhe "kapacitet bartës" janë karakteristika teknike të ndryshme;

Në bazë të analizës së mësipërme, vlerësohet se pretendimi i OE-së është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi është i bazuar në pjesën që konteston qartësinë dhe saktësinë e formulimit "peshë totale maksimum 1 ton", për shkak të mospërputhjes ndërmjet karakteristikës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit dhe karakteristikës së përmendur nga Autoriteti Kontraktues në përgjigjen ndaj OE-së.

Eksperti shqyrtues vlerson se nëse qëllimi i Autoriteti Kontraktues ka qenë sigurimi i një mjeti me kapacitet të caktuar bartës, duhet ta përcaktojë këtë karakteristikë në mënyrë të drejtpërdrejtë, të qartë, të matshme dhe teknikisht të verifikueshme, pa e zëvendësuar atë me një kriter të ndryshëm të "peshës totale".

Eksperti shqyrtues sqaron se në libreza të automjeteve, kamionëve etj., në Rep. e Kosovë përcaktohet:

1.Pesha maksimale e ngarkesës së lejuar dhe

2.Pesha e automjetit

Eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja duhet të sqaroj për OE se kjo makineri a nënkupton peshen makimale të ngarkesës së lejuar apo pesha e automjetit.

Eksperti shqyrtues gjithashtu sqaron se në Rep. e Kosovës nuk ka makineri me emertim Kamion me peshë maksimale 1 tonë por ka kamionet.

Pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Pergjigje ne pretendimin ankimor 2

Pretendimi ankimor lidhur me kërkesën teknike për "Gjysëmrimorkio kiper kran me sinjalizues të punimeve me peshë totale maksimum 3.5 t" vlerësohet pjesërisht i bazuar, për shkak të paqartësisë së formulimit dhe nevojës për një përshkrim më të saktë dhe funksional të kapacitetit teknik të kërkuar.

Nga shqyrtimi i kërkesës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit rezulton se Autoriteti Kontraktues ka identifikuar një mjet me një kombinim të veçantë karakteristikash, përkatësisht konstruksion kiper, kran, sinjalizues të punimeve dhe peshë totale maksimale 3.5 ton. Megjithatë, termi "gjysëmrimorkio" nënkupton një kategori specifike të mjetit rrugor, e cila, për funksionimin e saj, kërkon mjet të përshtatshëm tërheqës. Në këtë kuptim, nëse Autoriteti Kontraktues realisht ka pasur për qëllim një gjysëmrimorkio, atëherë duhet të jetë e qartë se si do të sigurohet mjeti tërheqës dhe nëse ky mjet përfshihet në kapacitetin teknik që duhet të dëshmohet nga Operatori Ekonomik.

Nëse, nga ana tjetër, nëse nevoja reale e Autoritetit Kontraktues ka qenë sigurimi i një mjeti të pavarur për transport, ngarkim/shkarkim dhe sinjalizim të punimeve, atëherë përdorimi i termit "gjysëmrimorkio" nuk është teknikisht i përshtatshëm dhe krijon paqartësi për Operatorët Ekonomikë lidhur me mjetin konkret që duhet të ofrohet.

Për më tepër, specifikimi i një kombinimi të ngushtë të karakteristikave – "kiper", "kran", "sinjalizues të punimeve" dhe "peshë totale maksimum 3.5 t" – duhet të justifikohet nga nevojat reale të kontratës. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të përcaktojë kërkesa teknike që sigurojnë kapacitetin e nevojshëm për realizimin e kontratës, mirëpo këto kërkesa duhet të lidhen me

objektin e kontratës dhe të jenë proporcionale me nevojën që synohet të përmbushet.

Në këtë rast, nuk rezulton mjaftueshëm e qartë nga formulimi i kërkesës se përse funksioni i kërkuar duhet të realizohet domosdoshmërisht nga një "gjysëmrimorkio" me këtë kombinim specifik karakteristikash, në vend që të lejohet edhe një mjet tjetër teknikisht ekuivalent, i cili realizon të njëjtin funksion dhe siguron kapacitetin e nevojshëm për punimet.

Pretendimi i Operatorit Ekonomik se një kamion ose kamionetë me konstruksion kiper dhe kran mund të kryejë të njëjtin funksion nuk mund të pranohet automatikisht vetëm mbi bazën e emërtimit të mjetit. Ekuivalenca duhet të vlerësohet mbi bazën e funksionit, kapacitetit teknik, ngarkesës së lejuar, kapacitetit të kranit, dimensioneve, pajisjeve të sigurisë dhe aftësisë së mjetit për të realizuar konkretisht punët e parapara në kontratë.

Megjithatë, pikërisht për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues duhet të përcaktojë qartë karakteristikat minimale funksionale dhe teknike që kërkohen, në vend që të kufizojë kërkesën vetëm në një emërtim ose konfigurim të caktuar të mjetit. Nëse qëllimi është sigurimi i një kapaciteti të caktuar teknik dhe funksional, atëherë një mjet tjetër që përmbush të njëjtat kërkesa dhe ofron performancë të barasvlershme, në parim, nuk duhet të përjashtohet vetëm për shkak se nuk ka të njëjtin emërtim ose konfigurim konstruktiv.

Sa i përket kërkesës për peshë totale "maksimum 3.5 t", edhe kjo karakteristikë kërkon sqarim teknik. Duhet të përcaktohet nëse bëhet fjalë për peshën e vetë mjetit, masën maksimale të lejuar të mjetit, apo peshën totale të kombinimit mjet–ngarkesë. Këto janë kategori teknike të ndryshme dhe mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në numrin e mjeteve që mund ta përmbushin kërkesën. Për rrjedhojë, formulimi aktual nuk ofron qartësi të mjaftueshme për Operatorët Ekonomikë dhe mund të krijojë interpretime të ndryshme gjatë përgatitjes së ofertave.

Prandaj, vlerësohet se pretendimi është i bazuar në pjesën që lidhet me paqartësinë dhe nevojën për riformulim të specifikimit teknik.

Eksperti shqyrtues sqaron se rekomandon panleshin shqyrtues se Autoriteti Kontraktues duhet të rishikojë kërkesën dhe të përcaktojë në mënyrë të qartë:

1. nëse kërkohet gjysëmrimorkio apo rimorkio/mjet motorik;
2. në rast se kërkohet gjysëmrimorkio, cili është mjeti tërheqës dhe si sigurohet ai;
3. çfarë nënkuptohet saktësisht me "peshë totale maksimum 3.5 t";dhe pse kërkohet kjo peshë maksimale
4. cilat janë kapacitetet minimale funksionale dhe teknike të kiperit dhe kranit;
5. cilat janë kërkesat konkrete për sinjalizimin e punimeve; dhe
6. nëse funksioni i kërkuar mund të realizohet edhe përmes një mjeti tjetër teknikisht ekuivalent.

Në këtë drejtim, Autoriteti Kontraktues duhet të shmangë përcaktimin e një konfigurimi specifik të mjetit nëse nuk mund të demonstrojë se ky konfigurim është objektivisht i domosdoshëm për realizimin e kontratës. Në vend të kësaj, specifikimi duhet të fokusohet në rezultatin dhe kapacitetin teknik të nevojshëm, duke lejuar, kur është teknikisht e arsyeshme, edhe mjete ekuivalente që përmbushin kërkesat minimale të përcaktuara.

Megjithatë, eksperti shqyrtues vlerson se kërkesa e Operatorit Ekonomik që të pranohen në mënyrë të pakushtëzuar "kamion" ose "kamionetë" me konstruksion kiper dhe kran nuk mund të aprovohet pa një verifikim teknik të ekuivalencës. Autoriteti Kontraktues duhet fillimisht të përcaktojë funksionet dhe kapacitetet që duhet të përmbushë mjeti dhe më pas të vlerësojë nëse format alternative të propozuara i përmbushin ato.

Eksperti shqyrtues vlerson se pretendimi ankimor pranohet pjesërisht si i bazuar, në pjesën që konteston qartësinë dhe përshtatshmërinë e formulimit të kërkesës teknike. Kërkesa "Gjysëmrimorkio kiper kran me sinjalizues të punimeve me peshë totale maksimum 3.5 t" nuk është formuluar me nivelin e nevojshëm të qartësisë teknike dhe kërkon sqarim/riformulim nga Autoriteti Kontraktues.

Ndërsa pretendimi se duhet të pranohen automatikisht kamionët ose kamionetat me konstruksion kiper dhe kran nuk mund të konsiderohet i bazuar pa u përcaktuar paraprakisht dhe pa u verifikuar ekuivalenca e tyre teknike dhe funksionale me nevojën reale të kontratës.

Për rrjedhojë, rekomandohet që Autoriteti Kontraktues të rishikojë specifikimin teknik, duke e orientuar atë drejt kërkesave minimale funksionale dhe të performancës, duke shmangur kufizimet e panevojshme të bazuara vetëm në emërtimin ose konfigurimin e një lloji të caktuar të mjetit, dhe duke garantuar që çdo mjet alternativ që plotëson në mënyrë të barasvlershme kërkesat teknike dhe funksionale të mund të konsiderohet i pranueshëm.

Pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e OSHP-se lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi dhe funksionalizimi i shtepise per mbrojtjen e femijeve" me numër të prokurimit:632-26-5571-5-1-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës vendos tja fal besimin e plotë rekomandimit të ekspertit shqyrtues i cili ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik"Ved Group" SH.P.K.aprovohet si pjeserisht e bazuar dhe Ak të bëjë përmirësimet e Dosjes së tenderit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndertimi dhe funksionalizimi i shtepise per mbrojtjen e femijeve"me numër të prokurimit:632-26-5571-5-1-1qe AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim, sipas rekomandimeve të ekspertit shqyrtues.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA E GJAKOVËS**
- OE - **VED Group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: